

VENDIM
Nr. 214, datë 14.10.2024

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SHA PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1315/3 prot., datë 4.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Axpo Albania’ sh.a. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Axpo Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1315/2 prot., datë 27.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Vlen të theksojmë se kjo shoqëri ka një licencë të vlefshme në këtë veprimtari deri më datë 20.12.2024.

- Duke qenë se shoqëria nuk aplikoi brenda datës 20.6.2024 për rinovimin e licencës, referuar nenit 16, pikës 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ku përcaktohet se, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, ka paraqitur aplikim për licencim nga e para.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, ghermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, ghermat “a” dhe “d”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë informacionin/ dokumentacionin në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për administratorin.

- **Germa “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative në gjuhën shqipe, origjinale ose të njëjësuar me origjinalin.

- **Pika 1.3.** Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **Germa “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë saktësimet përkatëse për sasinë e energjisë që parashikon të tregtojë gjatë 5 vjetëve të licencës, si dhe të dokumentojë mbështetjen financiare për ushtrimin e veprimtarisë për të paktën 1 muaj.

- **Germa “c”:** Shoqëria duhet të plotësojë planin e biznesit me parashikimin vjetor të të gjitha kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e veprimtarisë.

- **Pika 2.5.** Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në parashikimin e energjisë elektrike që do të tregtojë vitin e parë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Axpo Albania” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Axpo Albania” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti